



Republika e Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



16 05 2014

01-013/625

Prokuror - Prokurorë Mëkëmbës

Nr. i doses

Oriz

Vlera

Vrednost

Komuna e Vitisë

Në bazë të dispozitave të nenit 12. par. 2 shkronja c. dhe nenit 17. shkronja c. lidhur me nenin 58 shkronja h,,të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040(„G.Z e Republikës së Kosovës” nr 28/2008), mbështetur në dispozitat e nenit 2 të Ligjit për Tokën Bujqësore nr 02/L-26, si dhe konform dispozitave të nenit 22. par. 2 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 02-013/5165 datë 18.11.2008 Kryetari i Komunës së Vitisë propozon për miratim Kuvendit të Komunës së Vitisë këtë:

RREGULLORE

PËR MENAGJIMIN,RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE, MBROJTJEN E BIMËVE , PËRKUJDESIN NDAJ KAFSHËVE,MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR DHE BLETARINË NË KOMUNËN E VITISË

I – DISPOZITAT HYRSE

Neni 1

Qëllimi

- 1.1 Me këtë rregullore rregullohet, menagjimi, shfrytëzimi racional i tokës, mbrojtja e tokës dhe pasurive bujqësore me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të bimëve,kundër paraqitjes, parandalimit të përhapjes së organizmave të dëmshëm në bimë, mbajtja, kujdesi, strehimi, mbarështimi, transportimi dhe çështje të tjera të lidhura me përkujdesjen ndaj kafshëve, mbrojtjen e faunës së egër, mbarështimi i bletëve, masat për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve të bletëve, mbikëqyrjen e objekteve të prodhimit dhe ruajtjes së prodhimeve të bletëve në territorin e komunës së Vitisë.
- 1.2 Bazat mbi të cilat bazohen dispozitat e kësaj rregullore janë burimet formale-juridike të ligjeve pozitive të veçanta si Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L26. Ligji për Përkujdesjen ndaj Kafshëve Nr.02/L-10. Ligji për Gjuetin Nr.02/L-53,Ligji për Mbrojtjen e Bimëve Nr.02/L-95, Ligji për Bletarin Nr .02/L-111,LVQL, Nr. 03/L-040 si dispozitat e Statutit të Komunës së Vitisë.

II – PËRKUFIZIMET

Neni 2

Sipërfaqja tokësore e Komunës Vitisë	26993.59 ha
Tokë bujqësore pa kufi ndërtimor	9928 ha
Kullosa	3911.60 ha
Pyje	9588.50 ha
Sipërfaqja tjetër	3565.49 ha

Tokë bujqësore sipas kësaj rregulloreje konsiderohet çdo arë e shfrytëzuar ose e pa shfrytëzuar, kopsht, livadh, kullose etj., si dhe toka tjetër e cila sipas destinimit të vet, më së shumti do t'u shërbente interesave të përgjithshme në prodhimtarinë bujqësore.

“Bimë” nënkupton bimët e gjalla ose pjesët e tyre duke përfshirë edhe farërat

“Farëra” nënkupton farën e bimëve, farërat e drithërave, bimëve industriale, bimëve foragjere, perimeve, bimëve shëruese, aromatike, pemëve, luleve, drunjtëve pyjor që shërbejnë për mbjellje dhe riprodhim të deklaruar si material për shumim.

“Organizma të dëmshëm” nënkupton organizmat me origjinë bimore dhe shtazore ose patogjenët të cilët në forma të ndryshme shkaktojnë dëme në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera.

“Mbrojtja e bimëve” nënkupton, identifikimin, përcjelljen, pengimin, përhapjen, asgjësimin ose çrrënjosjen e organizmave të dëmshëm të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera duke zbatuar masat fitosanitare.

“Përkujdesje ndaj kafshëve” nënkupton të gjitha përpjekjet që sigurojnë nevojat fiziologjike dhe sociale të kafshëve;

“AUVK” nënkupton Agjencioni Ushqimit dhe Veterinës së Kosovës.

“Veterinar” nënkupton personin, i cili me sukses ka kompletuar aftësimin formal për mjekësi ose kirurgji veterinare në një fakultet të veterinës të aprovuar zyrtarisht nga Ministria kompetente;

“Mbajtës i kafshës” nënkupton personin i cili ka në ruajtje ose kujdeset për kafshën;

“Kafshë” nënkupton të gjitha kafshët e gjalla, duke përfshirë edhe shpezët, peshqit dhe bletët, larvat që jetojnë të lira dhe format larvare riprodhuese, por pa përfshirë format fetale ose embronike;

“Kafshët e egra” përfshinë kafshët dhe shpendët e egra të caktuara me ligj, që formojnë popullata në gjendje të lirë në natyrë ose në sipërfaqe të kufizuara të parapara për kultivim intensiv apo për shumim.

“Gjuetia” përfshin ndjekjen, plagosjen, vrasjen, ose zënien e kafshës, dhe çfarëdo përpjekje në këto aktivitete.

“E drejta e gjahut” është e drejta që në sipërfaqen e caktuar të tokës apo ujit (në vazhdim tokës) të ndërmer veprime dhe masa të kultivimit, mbrojtjes, shfrytëzimit të kafshës së egër dhe pjesëve të saj.

“Vend gjuetia” sipërfaqe e caktuar e tokës e cila paraqet tërësi natyrore ku ekzistojnë kushte ekologjike dhe kushte tjera për kultivim, mbrojtje, gjueti dhe përdorim të kafshëve të egra

“Sezoni i gjuetisë” koha në të cilën është e lejuar gjuetia në lloje të caktuara të kafshëve për gjueti.

“Ndalesa e gjuetisë” koha në të cilën është e ndaluar gjuetia për lloje të caktuara të kafshëve për gjueti.

“Bletari” - nënkupton mbarësh-timin, rritjen, shumëzimin, prodhimin dhe qarkullimin e bletëve të specit *Apis Mellifera*, prodhimeve të bletëve si dhe pajisjet për bletari;

“Bletë” - nënkupton amat, bletët punëtore dhe brumbujt;

“Shoqëri bletësh” - nënkupton bashkësinë e amave, bletëve punëtore dhe brumbujve të vendosura në zgjua;

“Bletore” - vendi ku vendosen zgjojet me bletë, mund të jenë të hapura ose në ndonjë shtëpizë me etazhe, por mund të vendoset edhe në makina për transport;

“Prodhimet e bletëve janë” - mjalti, dylli, propolisi, luzma e bletës dhe helmi i bletës (apitoksina);

“Bletar” - person fizik ose juridik i cili merret me bletari për përfitimin e prodhimeve të bletëve dhe amave të bletëve;

“Mjalti natyral” - nënkupton mjaltin dhe prodhimet e mjaltit pa përdorimin e shtojcave dhe pa trajtim me mjete kimike;

Neni 3

Toka bujqësore si pasuri me interes të përgjithshëm shfrytëzohet vetëm për prodhimtarinë bujqësore dhe gëzon mbrojtjen e veçantë.

Neni 4

Shfrytëzimi racional i tokës bujqësore është me interes të përgjithshëm. Shfrytëzuesve nuk u lejoheq që tokën bujqësore t'a mbajnë të pa punuar, dhe që me rastin e punimit t'i zbatojnë masat agroteknike dhe agro melioruese.

Neni 5

Pronari i tokës bujqësore obligohet që tokën bujqësore t'a shfrytëzoj në mënyrë racionale dhe se paku t'a punoj në mënyrën e rëndomtë si që punohet ajo në territorin e komunës. Pronari i tokës bujqësore me rastin e punimit të tokës obligohet të aplikoj masat agroteknike dhe masat tjera, afatet optimale, përdorimin e farës cilësore etj.

Neni 6

Pronari i tokës bujqësore gjatë punimit të tokës së vet bujqësore obligohet që sa më pak të shkaktoj dëme fqinjëve të vetë.

Neni 7

Pronari i tokës bujqësore të cilit i pengohet hyrja në tokën e vet bujqësore ka të drejtë që të kërkoj kalimin nëpër tokën e fqinjëve në afatin kohor të nevojshëm për punimin dhe shfrytëzimin racional të tokës bujqësore.

III – SHFRYTEZIMI I TOKES BUJQËSORE PËR QËLLIME JOBUIQËSORE

Neni 8

Toka bujqësore e klasës I, II, III dhe IV nuk mund të përdoret për qëllime jobujqësore.

Toka bujqësore nga klasa I-IV, e cila gjendet brenda planit zhvillimor dhe urbanistik të komunës, lejohet ndërrimi i destinimit të përhershëm nga toka bujqësore në tokë ndërtimor, duke i përfillur procedurat e parapara me Ligjin për Tokën Bujqësore.

Toka bujqësore e klasës së I-IV, jashtë planit zhvillimor dhe urbanistik, mund ti ndërrohet destinimi me Vendim të Kuvendit të Komunës për raste: ndërtimin e shkollave, çerdheve, fushave sportive, ndërtim të fabrikave, si dhe në rast të ndonjë projekti që ka të bëjë me zhvillimin e bujqësisë.

Neni 9

Ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 5 deri 8 brenda planit zhvillimor komunal, do të bëhet me vendimin e Drejtoriasë së Bujqësisë dhe pëlqimin urbanistik të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim.

Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës 5 deri 8, brenda planit zhvillimor komunal, do të bëhet me vendimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe pëlqimin urbanistik të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim.

Neni 10

Parashtruesi i kërkesës për ndërrimin e destinimit duhet të paraqes informatat dhe dokumentacionin si vijon:

- a) Kopja e planit
- b), klasa e tokës;
- c) Dëshminë e pronësisë, përmes certifikatës së pronësisë nga regjistri i të drejtave në pronën e paluajtshme ose dëshminë e të drejtës së shfrytëzimit të tokës, përmes pëlqimit të pronarëve ose kontratës që i mundëson parashtruesit të kërkesës të bëjë kërkesë për ndërrim të destinimit;

Neni 11

Ndërrimi i përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore me qëllim të shfrytëzimit të gurëve, vendosjes së mbeturinave të hedhura etj., bëhet në pajtim me Vendimin e Kuvendit komunal.

Vendimin për ndryshimin e kulturës së tokës bujqësore e bënë organi komunal i administratës kompetent për punët e gjeodezisë.

Neni 12

Personave të cilëve u lejohet ndërtimi i objekteve ekonomike, të banimit dhe i objekteve të tjera të standardit shoqëror do të paguajnë kompensimin për njësi të sipërfaqes sipas Vendimit mbi caktimin e taksave komunale.

Kompensimi nga ky neni bëhet në llogari të Buxhetit të KK Vitisë.

Neni 13

Drejtorati për urbanizëm obligohet që me rastin e lëshuarës së Lejeve të ndërtimit paraprakisht të kërkojë nga parashtruesit e kërkesës Pëlqimin për shndërrimin e tokës nga organi kompetent komunal- Drejtorja Për Bujqësi Pyltari Dhe Zhvillim Rural

IV – DHËNJJA ME QIRA E TOKËS BUJQËSORE

Neni 14

Pronarët e tokave bujqësore (Publik apo privat), të cilët në një mënyrë apo tjetër nuk janë në gjendje të punojnë tokën bujqësore sugjerohen nga organet kompetente për bujqësi që tokën bujqësore t'a japin me qira atyre që dëshirojnë t'a punojnë.

Dhënia e tokës bujqësore me qira bëhet me anën e kontratës, e cila kohëzgjatjen e ka varësisht nga kulturat bujqësore që do të mbillen, a janë njëvjeçare apo shumë vjeçare.

Toka e marr me qira mund t'i jepet personit tjetër si nënkontraktor në shfrytëzim.

V – MBROJTJA E TOKËS BUJQËSORE

1. Mbrojtja nga erozioni

Neni 15

Tokë bujqësore e rrezikuar nga erozioni konsiderohet toka në të cilën për shkak të ndikimit të ujit dhe të erës bëhet shpërlaja e fortë e gërmimeve dhe hapjeve të hullive etj.

Neni 16

Masa kundër erozionit përcaktohen me:

- Ndalesat e përkohshme ose të përhershme të rilavrimit të livadheve dhe kullotave dhe shndërrimin e tyre në ara me të mbjella njëvjeçare.
- Mbjellja e kulturave shumëvjeçare,

-Ndalimi i kullotjes së bagëtisë për një kohë të caktuar etj.

Neni 17

Pengimi i dëmeve të fushës

Me qëllim të mbrojtjes së pasurive bujqësore dhe të lashtave ndalohet:

-Lëshimi dhe kullotja e kafshëve në pasuritë e huaja bujqësore para se të mblidhen prodhimet bujqësore,

-Lëshimi dhe kullotja e kafshëve në pronën e huaj që është kopsht, pemishte, livadh artificial, jonxhe, tërfojë, vend i ri i pyllëzuar dhe kultura tjera të ngjashme gjatë tërë vitit,

-Thyerja dhe shkatërrimi i pemishteve në pasurinë e huaj,

-Mbledhja e frutave nga pemishtja e huaj

-Vjedhja dhe dëmtimi i mjeteve të huaja bujqësore,

-Shkulja, kositja, korrja dhe dëmtimi i të lashtave dhe kulturave tjera bujqësore dhe marrja e frutave nga pasuria e huaj,

-Lëshuarja e shtazëve - shpezëve në pasuritë e huaja bujqësore para se të jenë korrur – vjelur prodhimet bujqësore,

-Ndezja e zjarreve që paraqesin rrezik të fushave bujqësore, dhe pyjeve etj.

VI – MBROJTJA E BIMËVE

Neni 18

Mbrojtja e bimëve përfshin:

- (a) identifikimin dhe përcjelljen, pengimin dhe përhapjen e makro dhe mikro organizmave dëmtues në bimë, produkte bimore, objekte tjera që janë nën mbikëqyrje dhe çrrënjosjen apo asgjësimin e tyre;
- (b) përcaktimin dhe zbatimin e masave fitosanitare;
- (c) realizimin e obligimeve që dalin nga konventat, marrëveshjet, dhe kontratat ndërkombëtare nga lëmi i mbrojtjes së shëndetit të bimëve.

Neni 19

Prodhuesi i bimëve është i obliguar që:

- (a) gjatë periudhës së kultivimit të bimëve të mbajë nën kontroll shëndetin e bimëve, me qëllim të identifikimit, të parandalimit të përhapjes së organizmave të dëmshëm në sipërfaqet në të cilat kultivohen bimët si: ngastrat, plantacionet, fidanishtet, pemishtet, serrat dhe të ngjashme, bimët natyrore dhe produktet bimore, sikurse edhe objektet e tjera, pronar i të cilave është, apo dikush tjetër i shfrytëzon për nevojat e tija;
- (b) të informoi për shfaqjet e reja e të papritura apo nëse dyshohet për praninë e organizmave të dëmshëm në bimë dhe me këtë rast ai informon inspektorin fitosanitar, ose organin kompetent komunal.
- (c) menjëherë të ndërmarr masa, të cilat i përcakton organi kompetent komunal apo inspektori fitosanitar, me qëllim të pengimit, të përhapjes dhe të çrrënjosjes të organizmave të dëmshëm;
- (d) të mbajnë evidencë mbi masat e ndërmarra për mbrojtjen e bimëve dhe i mundëson personit zyrtar kontrollimin e tyre;
- (e) të mundësoj zbatimin e masave të përcaktuara nga organi kompetent;
- (f) të mundësoj dhe ndihmoj në kryerjen e kontrollit inspektues fito-sanitar.

Neni 20

Organi kompetent komunal në mënyrë të rregullt mban evidencën dhe i ruan të gjitha shënimet dhe rezultatet për paraqitjen e organizmave të dëmshëm dhe shënimet tjera të domosdoshme lidhur me përcjelljen e organizmave të dëmshëm, me qëllim të sigurimit dhe posedimit me informata të besueshme të cilat mund të jenë me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 21

Territori në të cilin nuk është konstatuar prania e një apo më shumë organizmave të dëmshëm, por në të cilin ekziston rreziku nga shfaqja e organizmave të tillë, organi kompetent komunal e shpallë zonë të mbrojtur.

VII – PËRKUJDESJA NDAJ KAFSHËVE

Neni 22

Me këtë rregullore rregullohet mbajtja, kujdesi, strehimi, mbarështimi, transportimi dhe çështje të tjera të lidhura me përkujdesjen ndaj kafshëve.

Neni 23

Përsoneat që merren me përkujdesje ndaj kafshëve duhet të sigurojë kushte e mira për kultivimin e kafshëve.

Neni 24

Personi që mban çfarëdo kafshe apo kujdeset për kafshën, do të jetë përgjegjës për sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e saj.

Eliminimi e kafshëve

Neni 25

Bëhet në rastet emergjente të cilat dukshëm tregojnë dhembje ekstreme që mund të pasojnë me ngordhje, atëherë vetëm veterinari ose personi tjetër kompetent lejohet të eliminoi kafshën e llojit të zbutur ose çfarëdo kafshe të egër e cila është zbutur, përmes eutanazisë .

Kafshët agresive

Neni 26

1. Ndalohet importimi, shitja apo mbarështimi e kafshëve agresive të cilat mund të paraqesin rrezik për sigurinë, shëndetin e njeriut dhe kafshëve të tjera në rastet kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj.
2. Kafshët agresive nuk duhet të mbahen në tufë dhe mund të eliminohen apo theren, kur ato paraqesin rrezik për shëndetin e kafshëve dhe të njeriut, nëse këtë më parë e vlerëson AUVK.
3. Varrosja e kafshëve bëhet në vende të veçanta të paraparë me planin zhvillimor

Transporti i kafshëve

Neni 27

1. Kafshët mund të transportohen, brenda vendit nga një lokacion në tjetrin apo jashtë vendit, vetëm nëse kafsha është:
 - a) e pajisur me certifikatë të shëndetit, të transportit të lëshuar nga AUVK, me të cilën vërtetohet se kafsha është e përgatitur për transport;
 - b) identifikohet me shenjë identifikimi- matrikulimi ose dokumente të paraqitura në certifikatë;
 - c) Nuk është përfshirë në kushtet dhe kufizimet të cila AUVK, i konsideron të duhura për zbatim;

d) Transporti duhet të jetë në pajtim me dispozitat e përcaktuara ligjore.

VIII – MBROJTJA E FAUNËS SË EGËR DHE ZHVILLIMI I GJUETISË

Neni 28

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet në veprimtaritë e ruajtjes, mbarështimit dhe të ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë sportive e turistike në territorin e komunës së Vitisë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje kanë për qëllim:
 - a. të sigurojnë ruajtje e shfrytëzim racional të llojeve të faunës së egër dhe të habitateve të tyre të përhershme e të përkohshme;
 - b. të programojnë aktivitetet e gjuetisë sportive e turistike brenda normave të caktuara në këtë rregullore;
 - c. të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të llojeve të faunës së egër;
 - d. të nxitin kërkimin shkencor në ruajtjen dhe mbarështimin e faunës së egër.

Neni 29

Regjistrimi dhe inventarizimi i fondit të faunës së egër

1. Drejtoria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural bënë inventarizimin dhe regjistrimin e sipërfaqeve dhe të popullatave të faunës së egër e të gjuetisë çdo dy vjet, duke bashkëpunuar me shoqatat e gjuetarëve, shoqatat mjedisore jofitimprurëse dhe institucionet kërkimore e studimore publike e private.
2. Me mbylljen e sezonit të gjuetisë, Drejtoria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural nxjerr dhe raporton të dhënat mbi ecurinë e veprimtarisë së gjuetisë, të cilat i dërgohen Sektorit të Faunës në Drejtorinë e Politikave të Mbrojtjes së Natyrës (DPMN).

XI – RREGULLAT E USHTRIMIT TË GJUETISË

Neni 30

Të drejtat dhe detyrimet në ushtrimin e gjuetisë

1. Të drejtat dhe detyrimet e ushtrimit të gjuetisë kanë të bëjnë me:
 - a. Mbrojtjen e gjahut dhe vendbanimet e tyre;
 - b. Gjuetia ushtrohet vetëm kur personat juridikë a fizikë të jenë pajisur me lejet përkatëse nga organet përkatëse
 - c. Gjuetari ose përgjegjësi i gjuetarëve duhet të organizojë ushtrimin e gjuetisë në përputhje me përdorimin e tokës, të mos dëmtojë kulturat e mbjella apo të korrat, me pëlqimin e pronarit ose përdoruesit të tokës, duke lëvizur e praktikuar mjetet e mënyrat që nuk shkaktojnë dëme.Drejtoria e Bujqësisë pylltarisë dhe Zhvillim Rural është kompetente për përcjelljen e planit vjetor të gjuetisë bazuar në Ligjin mbi Gjuetinë.

Neni 31

Kriteret dhe rregullat e ushtrimit të gjuetisë

1. Gjuetia konsiderohet një veprimtari sportive e turistike me qëllim vrasjen ose kapjen e gjahut nga gjuetari me mjete të lejuara sipas dispozitave ligjore dhe të rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Ushtrimi i gjuetisë sportive dhe turistike lejohet në të gjithë territorin e komunës, në zonat e lira dhe të rezervuara të gjuetisë, mbi bazën e lejes dhe të tarifave të miratuara.
3. Veprimtaria e gjuetisë sportive ushtrohet nga çdo shtetas kosovar, kur plotësohen këto kushte:
 - a. të ketë mbushur moshën mbi 18 vjeç;
 - b. të jetë i pajisur me lejen e gjuetisë;
 - c. të ketë lejen e mbajtjes dhe të përdorimit të armës së gjahut;
 - d. të jetë anëtar i shoqatës së gjuetarëve.

X – MBROJTJA E FAUNËS SË EGËR

Neni 32

Ruajtja e habitateve dhe e llojeve të faunës së egër

Habitatet dhe llojet e rrezikuara me zhdukje janë objekte të mbrojtura me ligj në përputhje edhe me konventat e pranuar nga shteti i Kosovës. Vrasja ose tregtia e këtyre llojeve është e ndaluar për shkak të rrezikimit të mëtejshëm të jetës së tyre si dhe lejohet vetëm në raste të veçanta, të parashikuara me dispozita ligjore apo dhe në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 33

Ruajtja e llojeve të kërcënuara dhe të rrezikuara të faunës së egër

Gjuetari por edhe personat e tjerë nuk duhet të rrezikojnë mbijetesën e llojeve të faunës së egër që nuk duhet të gjuhen dhe të organizmave të tjera të gjalla në fondin e gjuetisë

XI – BLETARIA

Neni 34

Regjistri i bletarëve

- 1 Personi fizik apo juridik që merret me bletari është i obliguar të lajmërojë në Drejtorinë Komunale për Bujqësi, deri më 30 prill të çdo viti kalendarik, për numrin dhe vendin e vendosjes së shoqërive të bletëve, për të hyrë në regjistrin e bletarëve.
- 2 Drejtoria e Bujqësisë, obligohet ta dorëzoj regjistrin e bletarëve në MBPZHR në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të afatit të regjistrimit

Vendosja e bletores

Neni 35

- 1 Bletorja mund të jetë e stacionuar apo lëvizëse.
- 2 Bletari është i obliguar të vendos bletoren në atë mënyrë që të mos pengoi fqinjët, kafshët dhe komunikacionin publik.
- 3 Ndalohet vendosja e bletores në afërsi të auto rrugëve.

4 Ndalohet vendosja e bletores në afërsi të fabrikave për prodhimin e sheqerit, lëngjeve, verërave, stallave dhe plehrishteve.

5 Personat individual dhe ndërmarrjet prodhuese që merren me prodhimin dhe përpunimin e pemëve dhe rrushit si dhe njësit e ngjashme tek të cilat përdorët ambalazhi që është i dëmshëm për bletë, obligohen të mbajnë në vend të mbyllur ambalazhin e përdorur.

6 Prodhuesit e lëngjeve, ose ëmbëlsirave të tjera janë të obliguar që me anë të rrjetave mbrojtëse të mbrojnë objektet e prodhimit ose depot e këtyre prodhimeve nga bletët, që të mos vijë deri te dëmtimi masovik i shoqërive të bletëve në këto objekte.

7 Kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni nuk do të zbatohen në vendet ku nuk ka lulëzim të bimëve edhe gjatë sezonit të dimrit.

Lëvizja dhe transporti i bletëve në kullota

Neni 36

Shfrytëzimi i kullotave nga bletët është i lirë dhe pa kompensim.

Neni 37

1 Çdo subjekt që ushtron veprimtarinë e bletarit i cili lëviz brenda ose jashtë Komunës me bletore duhet të bëjë kërkesë me shkrim në Zyrën e Drejtorisë Komunale për Bujqësi së paku 20 ditë para datës së lëvizjes.

2 Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe certifikata veterinare për gjendjen shëndetësore të bletëve dhe raporti për masat e ndërmarra veterinare.

Neni 38

Drejtoria Komunale për Bujqësi pasi të merr mendimin e ekspertit në bashkëpunim me Shoqatën e Bletarëve miraton apo refuzon vendosjen e bletores.

Neni 39

Çdo subjekt pas miratimit të kërkesës për lëvizjen e bletëve në vendin e caktuar, duhet të ruaj distancën nga bletoret tjera së paku 50 metra dhe të respektoj të gjitha detyrat e përcaktuara nga inspektori i veterinarisë për masat profilaktike dhe kurative që aplikohen në atë kohë në atë zonë.

Neni 40

Me rastin e vendosjes së bletores në kullota, bletarët duhet t'a vënë tabelën në vend të dukshëm, ku tregohet numri i shoqërive, identiteti dhe adresa e pronarit, numri i telefonit si dhe numri i bletores sipas regjistrimit të organit kompetent.

Neni 41

Tri ditë para vendosjes së bletëve në kullotë, bletari është i obliguar të njoftojë inspektorin veterinar komunal ose të blegtorisë për vendin e vendosjes së bletores.

Neni 42

Transportimi i bletëve në bletore mund të bëhet me të gjitha mjetet e transportit me kusht që të jenë të mbyllura për të penguar fluturimin e bletëve gjatë transportit.

Neni 43

Përveç pronarit që transporton bletët edhe përcjellësi i transportit të bletëve duhet të ketë njohuri për bletari.

Mbrojtja e bletëve

Neni.44

Bletari është i obliguar që në bletoren e vet të ndërmerë të gjitha masat për parandalimin, luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjeve duke përdorur preparatet e regjistruara dhe të aprovuara nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinar i Kosovës.

Neni 45

Përbërja kimike e mjaltit dhe produkteve të tjera të bletës duhet të përmbushin kërkesat mbi cilësinë e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit.

Objektet për përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit dhe prodhimeve të mjaltit

Neni 46

Personi fizik apo juridik i cili bën përpunimin dhe ruajtjen e mjaltit duhet t'i ketë këto hapsira:

- a) për pranimin, vjeljen e mjaltit dhe mirëmbajtjen e ambalazhit;
- b) për përpunimin, mbushjen dhe paketimin e mjaltit;
- c) për deponimin e prodhimeve të paketuara;
- d) për gardërobë dhe nyja sanitare.

Neni 47

Ndalohet vjelja e mjaltit nga kornizat ku ka çerdhe të bletëve,

Pyjet dhe tokat pyjore

Neni 48

Drejtoria e bujqësisë merr të gjitha masat për zbatimin e Ligjit mbi Pyjet e Kosovës për pyjet në territorin e Komunës së Vitisë.

Menagjimin, mbrojtjen, kultivimin, rritjen e sipërfaqeve të pyllëzimit, ripyllëzimit dhe inventarizimin vjetor të tyre.

Dënimet për shkelje në lëmin e pylltarisë janë të parapara sipas Ligjit në fuqi.

Masat për kryerjen e fushatës së Korrje-shirjes

Neni 49

- a) Duke u nisur nga fakti se korrja dhe shirja e grurit dhe drithërave tjera bëhet brenda një kohe edhe organizimi i punëve duhet të jetë në nivel të duhur.
- b) Me vonim të korrjes prej 5-10 ditë, rendimenti zvogëlohet për 4-10 %.
- c) Korrja dhe shirja duhet të bëhet atëherë, kur konstatohet se kultura në fjalë gjendet në fazën e pjekurisë së plotë .
- d) Çmimi i korrje shirjes përcaktohet në mvarësi prej tregut të lirë aktual.
- e) Autokombajnati duhet t'u përmbahen rregullave të korrje-shirje si që janë;
 - Që korrje-shirja të kryhet në afatin e paraparë dhe me cilësi e cila siguron që humbja e drithit të mos jetë me e madhe se 3-5%,
 - Lartësia e korrjes (stërnishtës) të mos jetë me e lartë se 15-20 cm,
 - Që me kohë të bëjnë të gjitha përgatitjet teknike dhe të tjera për kryerjen e korrje-shirjes .
 - Autokombajneri duhet që ti trajtoj të gjithë bujqit në mënyrë korrekte dhe pa asnjë dallim, të mbaj evidencën e saktë për korrje-shirje, në autokombajnë duhet të jetë e shënuar qartë shenja kundër zjarrit e cila duhet të respektohet nga të gjitha palët, si dhe të posedoj aparatit kundër zjarrit dhe mjetet tjera ndihmëse për këtë qëllim. .

f) Prodhuesit bujqësor janë të obliguar :

- Që me kohë t'i përgatisin ngastrat e tyre për kryerjen e korrje-shirjes pa pengesë duke përfshirë këto masa(pastrimin e barojave të këqija, shkurreve, eliminimin eventual të gardhiqeve dhe pengesave tjera);
- Që të siguroj rrugët kaluese për ngastrat (mbyllja e kanaleve, rrafshim i terrenit etj);

g) Për kushtet e korrje-shirjes autokombajnerat dhe bujqit duhet të informohen me kohë (organi kompetent për lajmërim është Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), ky organi është i autorizuar që :

- Të kontrolloj respektimin e afateve të përcaktuar për kryerjen e korrje-shirjes, gjendjen e rregullt teknike të makinave korrëse-shirëse, orarin e kryerjes së korrje-shirjes, gjendjen e rregullt të instrumenteve për matjen, mbrojtjen në punë, mjeteve mbrojtëse kundër zjarrit e të ngjashme,
- Që të ndaloj punën e makinave (autokombajnave),për kryerjen e korrje dhe shirjeve në rastet e gjendjes jo të rregullt teknike,ose të humbjes së drithit mbi masën 3-5%.

h) Nëse komisioni konstaton se autokombajnat nuk i plotësojnë kriteret e lartshënuara nga neni 49 pika e do ta largoj nga fushata e korrje-shirjeve.

i) për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Drejtori për Bujqësi, dhe inspektori i bujqësisë.

Ndërtimi i Objekteve për mbajtjen e kafshëve.

Neni 50

Komuna e Vitisë, Organi Kompetent për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, lëshon leje për ndërtimin e këtyre objekteve, bazuar në kriteret zooteknike për këtë qëllim, duke i'u përmbajtur Ligjit për mbrojtje të mjedisit.

XII – DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni.51

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do te kujdeset Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni.52

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga asambleja komonale

Kryesuesi i Kuvendit:

Skenderbe Hebibi

